

REPUBLIKA E SHQIPERISE
SHOQERIA "UJESJELLES - KANALIZIME" SH. A
ASAMBLEJA E PERGJITHSME E AKSIONEREVE
S A R A N D E

VENDIM I ASAMBLESË SË PËRGJITHËSHME TË SHOQËRISË
UJESJELLES KANALIZIME SARANDE SH.A.

NR. 1 DATË 14/04/2023

Sot, më datë 14 Prill 2023, Ujesjelles Kanalizime Sarande sh.a., një shoqëri e themeluar sipas ligjit shqiptar, me kodin unik NIPT J64228814D, mbajti mbledhjen e Asamblesë. Mbledhja u thirr nga administratori i shoqërisë zoti Sheme Lulo, për të diskutuar mbi rendin e ditës si vijon:

Çështjet e rendit të ditës:

- Prishja e shoqërisë dhe shpallja e saj në likuidim;
- Emërimi i Likuidatorit.

Në shqyrtim të rendit të ditës, Asambleja vëren:

Shoqëria Ujesjelles Kanalizime Sarande sh.a. nuk zhvillon më aktivitete pasi në përputhje me VKM Nr. 302, datë 11.05.2022 si dhe me marrëveshjen noteriale Nr. 23 Rep. dhe Nr. 16 Kol, datë 12.01.2023 midis shoqërisë Ujesjelles Kanalizime Sarande sh.a. dhe shoqërisë Shoqëria Rajonale Ujësjele Kanalizime Sarandë sha, kjo shoqëri e ka transferuar veprimtarinë ekonomike si dhe aktivet dhe detyrimet e saj në tërësi. Nga data 1.3.2023, kjo shoqëri nuk ka më të drejtë të zhvillojë aktivitetin për të cilin ajo është themeluar.

Për sa konstatohet më sipër, shoqëria e ka përmbushur qëllimin e krijimit dhe nuk ka më arsye të vijoje ekzistencën e saj dhe duhet të priset dhe të cregjistrohet nga regjistri tregtar QKB.

Pasi diskutoi gjerësisht mbi rendin e ditës, Asambleja vendosi:

- (1) Përfundimin e aktivitetit të shoqërisë dhe prishjen e saj
- (2) Shoqëria shpall hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese;
- (3) Emërimin e Z. Sheme Lulo si likuidator të shoqërisë.
- (4) Likuidatori është i autorizuar të përgatisë Raportin Përfundimtar të likuidimit të shoqërisë. Ai është gjithashtu i autorizuar të kryejë të gjitha veprimet e nevojshme në përputhje me legjislacionin e aplikueshëm për likuidimin e shoqërisë si dhe të kërkojë, paraqesë çdo dokument të nevojshëm pranë autoriteteve private dhe publike në lidhje me likuidimin e shoqërisë.

Pasi u siguroa se nuk ka më çështje për diskutim, mbledhja mbyllet dhe vendimi nënshkruhet në 3 kopje identike si vijon:

